



Prishtinë, 11 nëntor 2010

Kodi i ZRRE-së: V_299_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenin 15 paragrafi 2 pika (d) dhe nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.2004/9 të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
- Nenin 4, 13 dhe 14 të Rregullit për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, rrjetave të gasit, linjave direkte elektroenergjetike dhe linjave gypore direkte;
- Kërkesën për shndërrimin e Njoftimit mbi Vendimin Preliminar në Autorizim për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, me kapacitet të instaluar prej 900 kW, në lokacionin “Bostan” KK Novobërdë, të datës 29.07.2010 të ndërmarrjes Wind Power SH.A, me adresë Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr.68, hyrja 9, Ulpiana/ Prishtinë, Republika e Kosovës;
- Lejet, pëlqimet dhe vendimet e lëshuara nga institucionet përgjegjëse, si në Shtojcën II të këtij Vendimi,

në seancën e mbajtur me datë 11 nëntor 2010 nxori këtë:

VENDIM PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT

- I. Ndërmarrjes “Wind Power” SH.A i **lëshohet AUTORIZIMI** për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE) – era, që përbëhet prej dy (2) turbinave, secila me nga 450kW , me kapacitet të instaluar prej 900 kW, në lokacionin “Bostan” KK Novobërdë.

Arsyetim

ZRRE me datë 17.08.2009 nga ndërmarrja **Wind Power SH.A**, ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim të kapacitetit të ri gjenerues nga burimet e ripërtëritshme (BRE) – era, që përbëhet prej dy (2) turbinave, secila me nga 450kW, me kapacitet të instaluar prej 900 kW, në lokacionin “Bostan”, Zona Kadastrale KK Novobërdë.

ZRRE pas konstatimit se Aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapacitetit gjenerues nga burimet e ripërtëritshme të energjisë nga era me kapacitet instalues prej 900 kW, me datë 24 qershor 2010 ka lëshuar Vendimin mbi Autorizimin Preliminar Nr .V_248_2010 dhe ka udhëzuar Aplikuesin që t’i plotësojë kushtet tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë.

ZRRE, pas vlerësimit të dëshmime të bashkangjitura dhe pranimit të dëshmime plotësuese të kërkuara, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda (14) ditësh nga pranimi i Vendimit ose nga data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bashkangjitur këtij Vendimi janë:

Shtojca I : Autorizimi për ndërtimin e kapacitetit gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, me kapacitet instalues prej 900 kW, në lokacionin “Bostan”, zona kadastrave, KK Novobërdë.

Shtojca II: Lista e dokumenteve (lejeve, pëlqimeve, vendimeve, kontratave, etj.) të lëshuara nga institucionet e Kosovës.

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar.